

## SHP STRUGË

## Pensionistët nga Struga kërkojnë një shtëpi dinjizote për të moshuarit

Pensionistët e Strugës po kërkojnë një shtëpi dinjizote për të moshuarit. Ata besojnë se kanë të drejtë të përdorin dy objektet, të cilat dy dekada më parë ishin shtëpi të pensionistëve, dhe sot asnjëra nuk është e tyre. Kështu, njerëzit e moshës së tretë në rajon kanë mbetur vetëm. Shumë prej tyre nuk kanë askënd që të kujdeset për ta, të gatujë për ta, t'i blejë, madje edhe t'i mbështesë. "Si shoqatë ne përpiqemi të sigurojmë që kjo pjesë e popullsisë të mund të jetojë pjesën tjetër të jetës së tyre në një mënyrë të denjë. Pensionistët nga e gjithë Maqedonia ishin të pranishëm në ato vendpushime. Hoteli "Plaza" ka një kapacitet prej 30 dhomash, dhe hoteli "Galeb" 80. Të dyja janë ndërtuar nga SPIM për nevojat e pensionistëve. Sipas fletë pronësisë, ndërtesat janë në pronësi të Republikës së Maqedonisë me të drejtën e përdorimit të Shoqatës së pensionistëve Strugë, por ato menaxhohen nga persona privatë. Objektet janë në menaxhim të një Shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, e cila drejton biznese private të hotelerisë. Ata janë të mbyllur gjatë gjithë vitit, hapen vetëm për një ose dy muaj gjatë verës, dhe pastaj janë të mbyllura. Kjo ka dëmtuar pensionistët nga ky rajon, por edhe më gjerë", thotë Milorad Trposki, kryetar i Shoqatës së pensionistëve nga Struga. Pensionistët e Strugës, rreth 4.400 në numër, po kërkojnë nga Ministria e Punës dhe Politikës sociale, LSHPM dhe organe të tjera kompetente në vend që të marrin masa që pensionistët të kthehen në menaxhim të objekteve në bregun e liqenit të Ohrit dhe në to të akomodohen të moshuarit. Duke marrë parasysh se nuk ka asnjë shtëpi të vetme pleqsh në rajon, kësaj kërkeje i bashkohen shoqatat e pensionistëve nga Dibra, Labunishta, Vevçani, Kërçova dhe Makedonski Brod, duke shpresuar se zëri i tyre do të dëgjohej dhe ky problem do të zgjidhet. (S. Kukuneshoski)

## REVYTË REPUBLIKANE DHE RAJONALE TË PENSIONISTËVE

## PENSIONISTËT, ROJTARËT E VËRTETË TË PASURISË DHE TRADITËS SONË MULTIKULTURORE

Edhe këtë vit, pensionistët treguan shpirtin e tyre të pathyeshëm, devotshmërinë e tyre ndaj trashëgimisë sonë kulturore folklorike, duke thënë se asgjë nuk është e vështirë kur duhet, respektohet, mbrohet pasuria kulturore, tradita dhe identiteti

Ndjenja e përkatësisë ndaj rrënjëve të tyre u tregua me dinjitet nga pensionistët edhe këtë vit, parvarësisht nga pandemia e koronavirusit Covid-19. Përfaqësuesit e mbi 270.000 pensionistëve anëtarë të LSHPM, nga e gjithë Maqedonia e kanë treguar këtë duke iu përmbytur të gjitha rekomandimeve të Qeverisë dhe Lidhjes së Shoqatave të Pensionistëve të Maqedonisë në mënyrë që të mbrojnë shëndetin e tyre, shëndetin e të dashurve të tyre dhe më gjerë. Sidoqoftë, ata nuk e thyen traditën e mbajtjes së këtyre ngjarjeve tradicionale të pensionistëve të njohura dhe të mbështetura nga Ministria e Kulturës. Këndohej dhe shoqërohej të përcjellë me tingujt e instrumenteve tona popullore kombëtare, të cilat përdoren në këtë zonë. Por e gjithë kjo nuk do të kishte qenë ashtu, pa mbështetjen e Qeverisë dhe ministrive të saj në të kaluarën, dhe veçanërisht në këto vitet e fundit për të cilat pensionistët janë veçanërisht mirënjohës. Ishte kështu gjatë këtyre dy viteve pandemike në të cilat në këto ditë të vështira gjetën mbështetjen e Qeverisë, sidomos Kryeministrit të Maqedonisë së Veriut, Zoran Zaev. Kujdesi dhe mirëkuptimi i tij për të gjitha problemet e banorëve më të vjetër gjithmonë është dhënë, natyrisht brenda kufijve të mundësive të shtetit.

Më 23 qershor edhe të këtij viti u



këndua, recitua dhe u luajt dhe megjithëse këngët dhe tingujt ngjallnin nostalgji dhe keqardhje për rininë, ato gjithashtu ngjallën kujtime dhe mbresa të mira.

E njëjta atmosferë ishte e pranishme në të tetë shfaqjet rajonale të këngëve, muzikës dhe vallëzimit, megjithëse vallëzimi dhe shfaqjet masive munguan për shkak të situatës aktuale.

Kështu ishte në Dellçevë, në Maleshevi, qyteti që mban emrin e krenarisë së Maqedonisë, Goce Dellçev, kështu ishte edhe në Shtip, qyteti nën Isar, kështu ishte në Kumanovë, në qytetin e njohur për shaka, ashtu ishte në Cjevergjele, qyteti i shpellave, kështu ishte në Tetovën multietnike, në Strugë, qyteti i poezisë buzë liqenit të bukur të Ohrit dhe në Prilep, qyteti i heroit, vendlindja e të madhit Bllaze Koneski. Në të gjitha këto qytete, nikoqirë ishin shoqatat e pensionistëve, ndërsa organizuesit të tetë revyve të 19-ta rajonale me radhë dhe revyve të 11-të republikane të këngëve, muzikës dhe lojërave ishte Lidhja e shoqatave të pensionistëve të Maqedonisë.

Kryetarja e LSHPM, Stanka



Trajkova ishte e para që iu drejtua të pranishmëve, e cila i përshëndeti të pranishmit, përfshirë kryeministrin, Zoran Zaev. "Me kënaqësi dhe krenari të veçantë ju përshëndes të gjithëve dhe ju përgëzoj për guximin dhe mençurinë që këtë vit, në mënyrë të organizuar dhe dinjizote, ju morët përsipër të mbani tetë radhë përmblendhje të këngëve, muzikës dhe lojërave, edhe pse në një formë të ndryshuar dukshëm. Jam krenarë për të gjithë ju sepse të gjithë jetojmë së bashku duke ndërtuar bashkëjetesën dhe miqësinë. Sepse të gjitha arritjet dhe sukseset tona janë rezultat i unitetit dhe mirëkuptimit tonë. Kështu ka qenë në 75 vitet e fundit, kështu ne do të ecim në të njëjtën rrugë në të ardhmen. Qofshim të gjallë dhe të shëndetshëm dhe të festojmë edhe shumë përvjetorë kaq të rëndësishëm për ne dhe brezat e të gjithë pensionistëve të ardhshëm. Cëzuar 75 vjetorin!", u shpreh Stanka Trajkova.

Pastaj kryeministri Zaev iu drejtua të pranishmëve. "Të nderuar pensionistë, kujdesi për ju dhe pro-



blemet tuaja është i vazhdueshëm. Do të jetë kështu edhe në të ardhmen. Unë ju përgëzoj për 75 vjetorin dhe ju uroj shumë shëndet dhe plot aktivitete dhe arritje në pension. Unë e deklaroj të hapur Revynë e 11-të republikane", theksoi Zaev.

Pas përshëndetjeve dhe adresimeve të tyre, u kënduan këngë të bukura popullore dhe të vjetra qytetare, u dëgjua zëri i curleve dhe kalvalleve, dhe rrahja e daulles. Tingujt ishin të ndërthurur me kostumet shumëngjyrëshe dhe veshjen solemne të interpretuesve. U kënduan këngët e vjetra tradicionale të krijuara në të kaluarën, këngë për dashurinë, këngë për vuajtjen, këngë për ekzistencën dhe trazirat nëpër shekuj. Këngët këndoheshin të ndryshme, por të barabarta dhe unike në një gjuhë të përbashkët, në gjuhën e miqësisë dhe të bashkëjetesës. Edhe këtë vit, pensionistët treguan shpirtin e tyre të pathyeshëm, devotshmërinë e tyre ndaj trashëgimisë sonë kulturore folklorike, duke thënë se asgjë nuk është e vështirë kur duhet, respektohet, mbrohet pasuria kulturore, tradita dhe identiteti.

Vetëm shoqatat që organizuan revytë rajonale kishin performancën e tyre edhe këtë vit. Çdo shfaqje, çdo interpretim u shpërblye me një duartrokitje të fortë nga publiku.

Në fund, u shpërndanë mirënjohje për pjesëmarrjen e të gjithë kryetarëve të shoqatave pjesëmarrëse në këtë Revy të 11-të Rajonale të këngëve, muzikës dhe lojërave, me shpresën që ky vit të jetë edhe më i bukur, më i lumtur dhe më masiv. (KSA)

## SHP KUMANOVË

## PENSIONISTËT NË TAKIM PUNE ME KRYETARIN E KOMUNËS SË KUMANOVËS

Më 2 korrik të këtij viti u mbajt një takim pune ndërmjet kryetarës së Lidhjes së Shoqatave të Pensionistëve të Maqedonisë, Stanka Trajkova dhe kryetarit të SHP Kumanovë, Bllage Jakimovski me kryetarin e Komunës së Kumanovës, Maksim Dimitrievski. Në takim u diskutuan disa tema të rëndësishme për jetën e pensionistëve, në mënyrë që jeta e tyre të jetë më cilësore dhe të përfshihen më shumë në zgjidhjen e çështjeve që lidhen me ta. Në të, theksoi iu dha kujdesit institucional të pensionistëve, por edhe hapjes së

mundësive për kujdes jo-institucional në qendrat ditore, në Shtëpinë e vet pensionistëve e të tjera. Gjithashtu u diskutuan edhe shërbimet e Shtëpisë së të Moshuarve "Zafir Sajto" në Kumanovë. Projekti, sipas të cilit komuna do të subvencionojë transportin publik për pensionistët që kanë pensione deri në 11.000 denarë, është veçanërisht i rëndësishëm.

Në takim u arrit konkluzioni se deri më tani bashkëpunimi ndërmjet SHP Kumanovë dhe komunës është i mirë, por që në të

ardhmen Komuna e Kumanovës do të vazhdojë të kontribuojë në mbështetjen e aktiviteteve të pensionistëve, në mënyrë që të sigurojë kushte më të mira në të gjitha sferat e jetës shoqërore të pensionistëve. Pas takimit, kryetari i Komunës së Kumanovës, Maksim Dimitrievski, dhe kryetarja e LSHPM, Stanka Trajkova dhanë deklaratat për media për temat e diskutuara në takim.

Pas takimit, me kryetarin Dimitrievski, u vizitua Shtëpia e të moshuarve "Zafir Sajto" në Kumanovë. Përfaqësuesit e Shoqatës dhe SHP



Kumanovë, drejtori i Shtëpisë, Dejan Stojanovski i njoftoi ata me kushtet në shtëpi, e cila është një nga shtëpitë e pakta që mund të strehojë përfutues të pensioneve më të ulëta, por në të cilin strehimi ka kushte

shumë të mira për akomodim dhe që është shumë e rëndësishme në shtëpi ka një numër të vendeve të lira dhe mund të strehojë të moshuar edhe nga qytetet të tjera. (K.S Andonova)